



ALBANIAN
CHILDREN FOUNDATION

DOMENICK SCAGLIONE

www.albanianchildren.org

FONDACIONI
FËMIJËT SHQIPTARË
DOMENICK SCAGLIONE
AUTIZMI NUK ZGJEDH



NA MBËSHTESNI
SOT
TË JEMI TË PAVARUR
NESËR

**NDRIÇO BLU
PËR AUTIZMIN**

**FONDACIONI
FËMIJËT
SHQIPTARË
PRILL 2016**



WWW.ALBANIANCHILDREN.ORG

DITA NDËRKOMBËTARE E NDËRGJEGJËSIMIT MBI AUTIZMIN DHE NDRIÇO BLU PËR AUTIZMIN

Dita Ndërkombëtare e Ndërgjegjësimit


që përkujtohet çdi vit në datën 2 Prill, është caktuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për të rritur ndërgjegjësimin e popullatave rreth këtij çregullimi neurobiologjik.

Fondacioni Fëmijët Shqiptarë nëpërmjet aktiviteteve, takimeve, konferencave kombëtare e rajonale, prodhimit të librave të rinj, broshurave, video-mesazheve, spoteve publicitare dhe dokumentarëve, solli për të nëntin vit vëmendje për të gjithë individët në spektër të Autizmit në mbarë opinionin publik shqipfolës.

Ndriço Blu për Autizmin, fushata ndërkombëtare e frymëzuar nga organizata "Autism Speaks" që shpërndan ndërgjegjësim në të gjithë globin dhe rrit njohjen rreth autizmit, u përfaqëua edhe nga Shqipëria, duke u renditur kështu mes 157 vendeve të botës që nderuan miliona individë me autizëm dhe familjet e tyre.

Fondacioni Fëmijët Shqiptarë synon të shtojë ndjeshmërinë, të rrisë pranimin dhe të ngjallë shpresën po aq sa edhe të sjellë vëmendje ndaj nevojave të personave me autizëm pa dallim të moshës, ashpërsisë së simptomave dhe kushteve social-ekonomike që ata kanë.

autizmi nuk zgjedh...



FONDACIONI FËMIJËT SHQIPTARË
NËPËRMJET RRJETIT SOCIAL FACEBOOK
U DHA MUNDËSI NDJEKËSVE TË TIJ
TË MARRIN PJESË NË FUSHATËN NDËRGJEGJËSUESE
"NDRIÇO BLU PËR AUTIZMIN"
NËPËRMJET KARTËS SË PERSONALIZUAR
ME QËLLIM SHPËRNDARJEN E SAJ NGA SA MË SHUMË PROFILE.

Unë Ndrriçoj Blu

Fondacioni Fëmijët Shqiptarë
Tiranë-Shqipëri

Për të gjithë ata me Autizëm



 **AUTISM SPEAKS®**

#LIUB



JA SI NDRIÇUAM BLU PËR AUTIZMIN !

NDËRTESTAT ME SIMBOLIKË TË VEÇANTË VISHEN BLU PËR AUTIZMIN

Godinat e Presidencës, Bankës së Shqipërisë , Muzeut Historik Kombëtar , Godinat në Sheshin “Nënë Tereza” dhe Hotel Tirana International u ndriçuan BLU në fasadat e jashtme për të sjellë vëmëndje ndaj Autizmit.

Kjo nisëm, që shoqëritë anë e mbanë globit ndërmarin në shenjë solidariteti, konsiston në ndriçimin BLU të godinave me simbolikë të veçantë, si ato me karakter historik, kulturor, financiar etj , në mbështetje të personave me autizëm, të vlerësimit të potencialit që ata kanë dhe për të sjellë më shumë vëmëndje për nevojat e tyre.











TEG BËHET BLU PËR AUTIZMIN

Përgjatë muajit Prill, Qendra Tregtare më e madhe në vend Tirana East Gate ndriçoi BLU fasadën e jashtme të të gjithë godinës duke sjellë vëmendje për persona më çregullim të spektrit Autik.

Në të gjitha ambjentet e brëndëshme të godinës , dyshemeja u vesh me mesazhe ndërgjegjësuese në formë pazëlli të fondacionit për Autizmin, si:

“Dëgjoje zërin tonë”

“Ne jemi si fëmijët tuaj”


“Eja luaj me mua”

“Përtej mureve ka Jetë”

“Përtej mureve ka Shpresë”

“2 Prill, Dita Ndërkombëtare e Ndërgjegjësimit ndaj Autizmit”.






KUR DETAJET FLASIN PËR AUTIZMIN...





...ato detajet që na e bënë 2 Prillin, Ditën Ndërkombëtare të Ndërgjegjësimit mbi Autizmin në Kukës më të shprehur e më të bukur se asnjëherë tjetër...
 Sepse Autizmi foli këtë vit nga Kukësi me mesazhe konkrete...





VELA "AUTIZMI NUK ZGJEDH" FLUTURIM NËPËR SHQIPËRI...



Vela e Aeronautistit dhe fotografit të njohur shqiptar Alket Islami, me fluturim ndërgjegjësues nën logon e Fondacionit Fëmijët Shqiptarë dhe sloganin "Autizmi nuk zgjedh"!

Ndërgjegjësimit gjatë gjithë muajit për Autizmin që nga Kukësi e kudo nëpër Shqipëri sepse këtë vit Autizmi foli nga Kukësi .







CLUB CAVALIERO TIRANA VËMËNDJE PËR PËRSONAT ME AUTIZËM

Jo vetëm ART, MAGJI dhe ARGETIM por edhe NDERGJEGJESIM .

Stafi i Cavaliero Club Tirana, i është bashkangjitur me sloganin "Autizmi nuk Zgjedh" muajit të ndërgjegjësimit mbi Autizmin që mështetet nga Fondacioni Fëmijët Shqiptar. Me një performancë të shkëlqyer në skenën e "Cavaliero Club" Tiranë, instrumentistët dhe këngëtarët kanë mbajtur gjatë gjithë kohës të veshur bluzat me mbishkrimin "Autizmi nuk zgjedh" ndërsa në LED ËALL janë shfaqur mesazhet sensibilizuese të fushatës së Fondacionit : "Përtej mureve ka shpresë" & "Përtej mureve ka Jetë".

Faleminderit!







REKORDMENIA KLODIANA SHALA NDRIÇON BLU PALESTRËN PËR AUTIZMIN

Palestra e atletes dhe rekordmenes shqiptare Klodiana Shala ndizet BLU për Autizmin. Një grup të rinjsh që ushtrohen në këtë palestër kanë dhënë mesazhe ndërgjegjësuese për këtë kauze sepse "AUTIZMI NUK ZGJEDH"...







ME MESAZHET TONA KUDO NËPËR TIRANË PËRGJATË MUAJIT TË AUTIZMIT

Me mesazhet tona kudo nëpër Shqipëri përgjatë muajit të Autizmit

“Autizmi nuk zgjedh...”

“Përtej mureve ka jetë...”

“Përtej mureve ka shpresë...”

“Luaj me mua...”

“Ndriço dhe ti blu për autizmin...”

-janë këto disa nga mesazhet sensibilizuese të afishuara në banera, ekrane të mëdha qendrash tregtare dhe administrative e tabela reklamash kudo nëpër Shqipëri deri në aeroportin ndërkombëtar “Nënë Tereza” në Rinas.



NDRIÇO BLU "ON LINE" !

Me qindra individë në Shqipëri bënë fushatë ndërgjegjësimi për Autizmin nga adresat personale në rrjetet sociale. Kështu fushata Ndriço BLU për Autizmin u personalizua nga shumë përdorues të rrjetit social Facebook duke postuar në blu foton e profilit. Mekanizimi i kthimit në blu erdhi si nje ide origjinale nga organizata "Autism Speaks" e cila këtë vit e vuri theksin në mbizotërimin e ngjyres blu në rrjetet sociale dhe faqet e webe-ve..





DONATORËT

"Falënderim dhe Mirënjohje për të gjithë Donatorët që mundësuan mbështetjen e aktiviteteve dhe veprimtarive të Fondacionit "Fëmijët Shqiptarë", pasqyruar në këtë numër të revistës."

1. BANKA E SHQIPERISE
2. PRESIDENCA
3. HOTEL TIRANA INTERNATIONAL
4. UJI LAJTHIZA
5. MUZEU HISTORIK KOMBETAR
6. DELTA PHARMA
7. ALKET ISLAMI
8. TEG (TIRANA EAST GATE)





9. KLODIANA SHALA
10. CAVALIERO CLUB
11. CREDINS BANK
12. ABA BUSINESS CENTER
13. AGNA GROUP
14. RING CENTER
15. AEROPORTI NDERKOMBËTAR
I TIRANËS “NËNË TEREZA”
16. DIGIPRINT AL

UJI LAJTHIZA MESAZHE PËR AUTIZMIN...



Uji Lajthiza iu bashkua fushatës së ndërgjegjësimit gjithë muajit Prill duke loguar në shishen e tij mesazhe ndërgjegjësuese mbi Autizmin.